

Raport përmbledhës i Konferencës Ndërkombëtare në Inxhinierinë e Ndërtimit - ICCE 2023

Konferenca e dytë Ndërkombëtare e Inxhinierisë së Ndërtimit ICCE 2023 u zhvillua në Tiranë duke shënuar fillimin e një ngjarjeje të dedikuar eksplorimit të kufijve të inovacionit inxhinierik.

Konferenca u organizua nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit - Universiteti Politeknik i Tiranës dhe Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit - Universiteti i Prishtinës, ku synoi të sjellë së bashku inxhinierë, hulumtues, liderë të industrisë dhe entuziastë nga e gjithë bota për të shkëmbyer ide, ndarë njohuri dhe nxitur bashkëpunimin në fushën e inxhinierisë.

Hapja e konferencës nisi me fjalim frymëzues nga Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit- Universiteti Politeknik i Tiranës, Prof. Neritan Shkodrani dhe Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit- Universiteti i Prishtinës, Prof. Florim Grajçevci. Punimet e kësaj konference i mbështeti edhe Rektori nga Universiteti i Prishtinës, Prof. Dr. Qerim Qerimi, zv. Rektorja nga Universiteti Politeknik të Tiranës, Prof. Elfrida Shehu. Fjalë rasti në hapjen e konferencës adresoi edhe ministrja e Arsimit dhe Sportit nga Shqipëria, Dr. Albana Tole.

Pjesë e sesionit të parë ishin profesorë të shquar ndërkombëtarë të cilët prezentuan tema të ndryshme si Prof. Tatsunori Matsumoto i cili trajtoi temën “Testimi i ngarkesës së shpejtë në shtylla në Japoni”, Prof. Agathe Robisson i cili trajtoi temën “Sjellja e çimentos nën rrjedhjen e tubit”, Prof. Paolo Bazzurro i cili trajtoi temën “Zhvillimi i lakorave të brishtësisë për vlerësimin e rrezikut sizmik të ndërtesave specifike me fokus në teknikat e përzgjedhjes së lëvizjes së tokës”, Prof. Josip Atalic i cili trajtoi temën “Qendra Kroate për Inxhinierinë e Tërmeteve: Krijimi i platformës” si dhe Prof. Karel Pavelka i cili trajtoi temën “Përdorimi i teknologjisë “Mobil Mapping” në gjeomatikë për bazën gjeometrike të BIM”.

Një sesion i veçantë në ditën e parë të konferencës ishte tema e Eurokodeve, i moderuar nga Prof. Dr. Neritan Shkodrani dhe Prof. Ass. Dr. Florim Grajçevci, me folës nga e gjithë bota që ndanin përvojën e punës së tyre dhe vendeve të tyre. Pjesë e sesioneve interaktive ishin edhe prezantimet e temave me poster si dhe sesioni i studentëve.

Sesionet e ditës së dytë filluan me prezantime të ndryshme nga ekspertë të njohur nga fusha e inxhinierisë së ndërtimit. Konferenca filloi me fjalimet e ekspertëve të ftuar, profesorë të shquar ndërkombëtarë të cilët prezentuan tema shkencore të ndryshme dhe interesante. Sesioni i mëngjesit me ekspertët e ftuar filloi me prezantimin e Prof. Jose Antonio Silva de Carvalho Campos e Matos, i cili trajtonte temën “Nga rasti studimor në perspektivën botërore për menaxhimin e infrastrukturave ekzistuese”. Prezentimi i dytë ishte nga Prof. Dora Foti në fushën e “Vlerësimi i cënueshmërisë sizmike të ndërtesave sipas standardeve Italiane”. Ekspertët e ftuar vazhduan me sesionin e pasdites, me prezantimin e Prof. Luuk Dorren me temën “Ndryshimet klimatike dhe rreziqet natyrore: Pse inxhinieria e ndërtimit nuk mjafton?”, Prof. Fabio Masi “Zhblllokimi i potencialit të zgjidhjeve multidisiplinare të bazuara në natyrë në dizajnimin e sistemeve të qëndrueshme të kullimit”.

Sesionet ishin të klasifikuar në katër grupe gjatë paradites: Inxhinieri e Strukturave dhe e Tërmete, Inxhinieria Gjeoteknike, Teknologjia dhe Menaxhimi i Ndërtimit / Metodatat Llogaritëse në Inxhinierinë e Ndërtimit / Materialet Ndërtimore dhe Inxhinieria e Transportit / Ndërtesa dhe Monumente Historike. Gjatë pasdites u vazhdua me sesionet e tjera në: Kualiteti mjedisor / Trajtim i ujërave / Efiçencë dhe Energji e Ripërtritshme / Ndryshimet Klimatike dhe Adaptimi ndaj tyre / Inxhinieria për Zhvillim të Qëndrueshëm, Gjeodezi Inxhinierike dhe Monitorimi i Matjeve / Hartografi, Fotogrametri dhe RS / Infrastrukturë e të Dhënave Gjeo-hapësinore, GIS, Gjeoshkencë dhe Gjeomatikë, Inxhinieri e Hidraulikës / Hidrologji, Vërsime dhe Menaxhim i Ujit / Struktura Hidraulike.

Pas përfundimit të sesioneve, u zhvillua ceremonia përmbyllëse e konferencës ICCE 2023, me fjalime nga dy dekanët nikoqirë të konferencës. Gjatë përmbylljes u shpreh sërish mirënjohja ndaj prezantuesëve, moderatorëve, sponsorëve dhe të gjithë pjesëmarrësve dhe bashkëpunëtorëve që kontribuan në suksesin e kësaj konferencë. Konferenca përfundoi me ftesën dhe thirrjen për pjesëmarrje në edicionin e ardhshëm të konferencës që do të mbahet në Prishtinë.

Dita e tretë e konferencës ishte dedikuar vizitë në qytetin e Beratit, eksplorimi i trashëgimisë historike dhe kulturore të qytetit të Beratit. Fillimisht u vizitua Kalaja e Beratit, ku pjesëmarrësit e konferencës patën mundësinë të shohin pamjen e mrekullueshme panoramike të qytetit të vjetër dhe muzeun e Onufrit.

Dreka u organizua në një restorant tradicional në periferi të qytetit të Beratit ku të ftuarit patën mundësinë të provojnë një gamë të gjerë të ushqimeve të shijshme tradicionale. Konferenca u përmbyll me një vizitë në qytetin e Divjakës.